

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës			
Universiteti		Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	
Njësia akademike		Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës	
Programi		Informatika Industriale me Informatikë	
Titulli i lëndës		Detalet e Makinave	
Niveli		Bachelor	
Statusi lëndës		Obligative	
Viti i studimeve		II, Semestri IV	
Numri i orëve në javë		3	
Vlera në kredi – ECTS		5	
Koha / lokacioni			
Mësimdhënësi i lëndës			
Detajet kontaktuese			
Përshkrimi i lëndës		Kjo lëndë do t'i pajisë studentët me njohuritë dhe konceptet themelore të llogaritjes së tolerancave, ngarkesave, sforcimeve dhe shkallës së sigurisë së detajeve të ndryshme makinerike duke përdorur metodat ndryshme për zgjedhjen problemeve praktike në inxhinieri.	
Qëllimet e lëndës		Qëllimi i lëndës është përgatitja e studentëve me parimet themelore dhe të avancuara të përdorimit dhe të konstruktimit të pjesëve të ndryshme makinerike duke u bazuar në llogaritjet analitike dhe zgjedhjeve konstruktive të tyre.	
Rezultatet e pritura të mësimnxënies		Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti duhet të jetë në gjendje të: • njoh konceptin e tolerancave të detajeve makinerike, ngarkesat të cilat veprojnë si dhe shkallët e sigurisë të detajeve të ndryshme makinerike • kuptoj llogaritjet e tolerancave, sforcimeve, ngarkesave dhe shkallevë të sigurisë së detajeve të ndryshme makinerike (bulonave, transmetuesve me rripa dhe zinxhir, transmetuesve me dhëmbëzor, boshteve etj.) • zgjedhin metodat e duhura për llogaritjen e detajeve makinerike, • aplikojnë metodat e duhura teorike në zgjedhjen e problemeve praktike.	
Parakushtet		Nuk ka parakushte për të filluar të mësuarit e Detaleve të Makinave. Megjithatë, rekomandohet që studentët të kenë njohuri bazike të Matematikës dhe Mekanikës.	
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti

Mësim teorik dhe praktik	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren			
Kollokviume, seminare dhe projektet	2	10	20
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz dhe provim final)	1	5	5
Projektet dhe prezantimet	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies	<i>Ligjërata të kombinuara me detyra numerike dhe diskutime në klasë si dhe bashkëpunimi aktiv në ekip të studenteve</i>		
Metodat e vlerësimit	<i>Studenti mund të zgjedhë për t'u vlerësuar njërin nga dy format e vlerësimit, dhënë më poshtë:</i> <i>Forma 1: Vlerësimi me kollokviume dhe projekt</i> <i>Forma 2: Vlerësimi me provimin përfundimtar.</i> Forma 1: <i>Në formën e parë të vlerësimit” Vlerësimi me kollokviume dhe projekt “studenti vlerësohet në pesë aktivitete që realizohen gjatë ligjëratave:</i> <i>Kollokvium 1 (20%), vlerësim individual</i> <i>Kollokvium 2 (20%), vlerësim individual</i> <i>Kollokvium 3 (30%), vlerësim individual</i> <i>Aktiviteti në klasë (10%), vlerësim individual</i> <i>Projekti (20%), vlerësim grupor.</i> <i>Sqarim shtese:</i> <i>Nëse studenti në secilin aktivitet të mësipërm arrin pikët maksimale, atëherë ai do të vlerësohet me 100 pikë.</i> <i>Studentët të cilët e kalojnë provimin sipas formës 1 të vlerësimit, lirohen nga obligimi për t'iu nënshtruar provimit final. Vetëm nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin e arritur sipas formës 1, atëherë ai mund t'i nënshtrohet provimit final për të përfituar vlerësim më të lartë.</i> Forma 2: <i>Në formën e dytë të vlerësimit” Vlerësimi me provimin përfundimtar”, studenti do t'i nënshtrohet provimit i cili mbahet</i>		

	<i>pas përfundimit të ligjëratave të lëndës, dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit. Përmes provimit final studenti maksimalisht mund të arrijë 70% të pikëve nga totali prej 100 pikë.</i> <i>Pjesa tjetër e pikëve prej 30% duhet të plotësohet nga puna në Projekt dhe aktivitet i realizuar gjatë ligjëratave.</i> <i>Në Kollokvium 1, Kollokvium 2, Kollokvium 3 dhe provim përfundimtar vlerësimi i studenteve do të bëhet përmes:</i> <i>• Detyrave numerike me shkrim (detyrat studenti duhet t'i zgjidhë individualisht)</i> <i>• Pjesës teorike (pyetje/ese nga materiali i lëndës)</i> <i>Aktiviteti në klasë-nënkupton angazhimin e studentit në trajtim të çështjeve të diskutuara në klase, gjatë ligjëratave.</i> <i>Projekti (20%), vlerësim individual: është aktivitet në të cilin studentet zbatojnë në një projekt konkret njohuritë e fituara. Realizohet në mënyrë individuale nga studenti i cili ka për obligim ta realizojë aktivitetin, dokumentojë edhe prezantojë para profesorit të lëndës.</i> <i>Vlerësimi:</i> <i>91-100 pikë – vlerësohet me notë 10 (dhjetë)</i> <i>81-90 pikë – vlerësohet me notë 9 (nëntë)</i> <i>71-80 pikë – vlerësohet me notë 8 (tetë)</i> <i>61-70 pikë – vlerësohet me notë 7 (shtatë)</i> <i>51-60 pikë – vlerësohet me notë 6 (gjashtë)</i> <i>0-50 pikë – Studenti ri-përsëritë në provim.</i>
Raporti i teorisë dhe praktikës	70% teori me ushtrime dhe 30% punë laboratorike.
Literatura	
Literatura bazë	1. Dr sc Nijazi IBRAHIMI, DETALET E MAKINAVE I, Prishtinë 2004. 2. Dr sc Nijazi IBRAHIMI DETALET E MAKINAVE II/1 dhe 2, Prishtinë 2006. 3. Dr sc Sadullah AVDIU, PRAKTIKUMI I DHE II, Prishtinë 2003. 4. Dr sc Nijazi IBRAHIMI, DETALET E MAKINAVE I dhe II, Përmbledhje e detyrave të zgjidhura, Prishtinë, 2007.
Literatura shtesë	1. Nieman: Maschinenelemente, Band I & II. 2. Jashari I., Pllana G.: Detalet e makinave.
Plani i dizajnuar i mësimi	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Përmasat kryesore të pjesëve makinerike. Tolerancat. Pozita e fushave toleruese. Llojet e vendosjeve.

Java e dytë	<i>Aftësia bartëse e pjesëve makinerike dhe pjesët makinerike të ngarkuara me ngarkesa statike. Ushtrime numerike (tolerancat).</i>
Java e tretë	<i>Lidhjet e pjesëve makinerike (lidhjet filetore). Lidhjet me bulona. Ushtrime numerike (lidhjet me bulona).</i>
Java e katërt	<i>Lidhjet me ribatina. Sustat. Testi i I-rë (parë) (Mbahet pas javës së katërt)</i>
Java e pestë	<i>Transmetuesit. Transmetuesit me friksion. Transmetuesit me rripa. Transmetuesit me zinxhirë. Ushtrime numerike (transmetuesit me rripa dhe zinxhirë)</i>
Java e gjashtë	<i>Transmetuesit me dhëmbëzore (ndarja dhe përdorimi i tyre). Ligji themelorë i ingranimit.</i>
Java e shtatë	<i>Çiftet e dhëmbëzoreve cilindrikë me dhëmbë të drejtë dhe të pjerrtë. Profili standardë. Përmasat mbi dhëmbë dhe numri matës i dhëmbëve. Shkalla e ingranimit.</i>
Java e tetë	<i>Ushtrime numerike (Kalkulimi i fuqisë, numrave të rrotullimit, momenteve të rrotullimit të transmetueseve me dhëmbëzore, Shkalla e ingranimit).</i>
Java e nëntë	<i>Bartja e dhëmbëzoreve. Ngarkesat e dhëmbëzoreve. Analiza e forcave të dhëmbëzoreve.</i>
Java e dhjetë	<i>Boshtet. Akset. Kalkulimi paraprak dhe përfundimtar i boshteve. Testi i II-të (dytë) (Mbahet pas javës së dhjetë)</i>
Java e njëmbëdhjetë	<i>Lidhjet e boshteve (lidhjet e presuara, me kanale dhe me ndihmën e pykave). Kalkulimi i dorëzave.</i>
Java e dymbëdhjetë	<i>Kushinetat (kalkulimi dhe zgjedhja e kushinetës)</i>
Java e trembëdhjetë	<i>Lidhëset. Ushtrime numerike (kalkulimi i boshteve).</i>
Java e katërmbëdhjetë	<i>Ushtrime numerike (kalkulimi i boshteve, kushinetave)</i>
Java e pesëmbëdhjetë	<i>Testi i III-të (tretë)</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<i>Pjesëmarrja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është e nevojshme, si dhe pjesëmarrja aktive me diskutimin dhe zgjidhjen e detyrave. Telefonat celularë duhen të fiken ose të vendosen në modalitet të heshtur.</i>	